

Nr. Prot. 2660, datë 19.06.2025

Nr. Prot. 28, datë 19.06.2025

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET


DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PRONËSISË INDUSTRIALE (DPPI)

DHE

DHOMËS AMERIKANE TË TREGTISË NË SHQIPËRI (AMCHAM)

Kjo marrëveshje, lidhet ndërmjet palëve të mëposhtme:

- **“Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale”**, me seli në: “Bulevardi Zhan D’Ark”, Prona nr. 33, Ish-Shtëpia e Ushtarakëve, Tiranë, Shqipëri, regjistruar me Numrin Unik të Identifikimit të Subjektit (NUIS) K51726018J, me objekt veprimtarie si institucioni i vetëm përgjegjës për regjistrimin, administrimin dhe promovimin e të drejtave të Pronësisë Industriale në Republikën e Shqipërisë, detyrim që i buron nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nga ligji organik nr. 9947, datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale” i ndryshuar, neni 189, si dhe nga dokumente strategjike si: Marrëveshja e Asociim-Stabilizimit në nenin 73 të saj, “Pronësia Intelektuale”. DPPI funksionon në formën e një agjencie autonome, nën mbikëqyrjen e ministrit përgjegjës për ekonominë, pranë ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI), përfaqësuar nga Znj. Maria Solis Kapedani, në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Komanduar, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, këtu e më poshtë referuar si **“DPPI”**.



1



DHE

- **“Dhomës Amerikane të Tregtisë në Shqipëri”**, me adresë: Rruga “Ibrahim Rugova”, Sky Tower, Hyrja 11-3, Tiranë, Shqipëri, regjistruar me Numrin Unik të Identifikimit të Subjektit K11506006O. Që nga viti 2005, Dhoma Amerikane e Tregtisë në Shqipëri (AmCham) është anëtare e AmChams në Evropë (ACE), Këshillit Evropian të AmChams në Evropë. ACE u themelua në vitin 1963 dhe është një organizatë ombrellë që bashkon 44 AmChams, të cilat përfaqësojnë së bashku interesat e më shumë se 17,000 kompanive amerikane dhe evropiane, duke punësuar 20 milionë punonjës dhe duke përbërë më shumë se 1.1 trilion dollarë investime në të dy anët e Atlantikut. ACE përpaket të komunikojë rëndësinë e ekonomisë transatlantike si në Evropë ashtu edhe në Shtetet e Bashkuara, përfaqësuar nga Z. Neritan Mullaj, në cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv të Dhomës Amerikane të Tregtisë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, këtu e më poshtë, referuar si **“AMCHAM”**.

(veçmas do të quhen si **“Pala”** dhe bashkarisht si **“Palët”**)

Marrë në konsideratë sa më lart, palët bien dakord për kushtet dhe afatet si më poshtë:

PARIME TË PËRGJITHSHME

- a. Kjo marrëveshje bazohet në parimin e bashkëpunimit të ndërsjellë dhe respektimit të kompetencave institucionale të secilës palë;
- b. Bashkëpunimi do të realizohet vetëm nëpërmjet mënyrave të lejuara nga dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi që rregullojnë funksionimin e të dy palëve të kësaj marrëveshje bashkëpunimi dhe kërkesat rregullatore;
- c. Dispozitat e kësaj marrëveshjeje, nuk mund të çenojnë të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e secilës palë të marrëveshjes që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi, në bazë të të cilit janë krijuar dhe funksionojnë palët e marrëveshjes.
- d. Kërkesa për bashkëpunim dhe dhënie informacioni mund të mos plotësohet në këto situata:
 - i. Kur informacioni i kërkuar është në kundërshtim me ndonjë ligj apo akt që rregullon ruajtjen e konfidencialitetit;
 - ii. Kur kërkesa nuk është bërë në përputhje me dispozitat e vendosura në këtë marrëveshje.

NENI 1

QËLLIMI I MARRËVESHJES

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është bashkëpunimi i ngushtë, midis Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale dhe Dhomës Amerikane të Tregtisë në Shqipëri, për kryerjen e shërbimeve të specifikuara në nenin 3 të kësaj marrëveshjeje, në fushën e pronësisë industriale.

NENI 2 BAZA LIGJORE

Ligji nr.8788, datë 7.5.2001 “Për organizatat jo-fitimprurëse”, i ndryshuar.

Ligji nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, i ndryshuar.

Ligji nr.72/2012 datë 28.06.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Dhomave të Tregtisë”.

Ligji nr. 9978, datë 7.7. 2008,“Për Pronësinë Industriale”, i ndryshuar.

NENI 3 ANGAZHIMET E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PRONËSISË INDUSTRIALE

Mbi bazën e kësaj Marrëveshjeje, palët mund të ofrojnë shërbimet e mëposhtme:

- Konsulencë për bizneset në fushën e Pronësisë Industriale pranë AMCHAM;
- Trajnime profesionale dhe teknike për anëtarët e AMCHAM;
- Tryeza të përbashkëta midis aktorëve kryesorë të tregut që operojnë në fushat e PI-së;
- Nxitjen e sipërmarrjes për të mbrojtur asetet e PI-së;
- Hartimin e projekteve të përbashkëta dhe implementimin e tyre, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit tek SME, për rëndësinë e mbrojtjes së objekteve të PI-së dhe procedurat e mbrojtjes;
- Bashkëpunim dhe shkëmbim informacionesh sipas axhendave përkatëse të të dy institucioneve, si dhe koordinimin e kalendarëve të trajnimeve, programeve informuese për të gjitha kategoritë dhe sektorët e bizneseve për aplikimin për mbrojtjen e risive dhe inovacioneve teknologjike etj;
- Identifikimit të mekanizmave të shpërndarjes së informacionit në lidhje me pronësinë industriale, ku në bashkëpunim me AMCHAM, t’i përçohet informacioni dhe njohuria subjekteve dhe bizneseve në lidhje me pronësinë industriale;
- Shpërndarjes së materialeve informuese nëpërmjet AMCHAM, në lidhje me bizneset, veprimtaria e të cilëve është e lidhur ngushtë me pronësinë industriale;
- Organizimit të konferencave të përbashkëta, trajnimeve brenda dhe jashtë vendit, vizita studimore; sesione bisedimesh (workshops) me bazë vjetore, duke përdorur ekspertizën për plotësimin e kërkesave dhe nevojave specifike të SME-ve;
- Promovim të shërbimeve të palëve nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme në lidhje me ekspertizën përkatëse;
- Të gjitha materialet promocionale që do të përgatiten në bashkëpunim me AMCHAM, do t’u përmbahen rregullave të përdorimit të logos dhe shenjave të tjera dalluese të institucioneve respektive;
- Koordinimin sa me eficient të promovimit të aktiviteteve dhe shmangien e keqinformimit të publikut; informacionet, publikimet apo promovimet në portale të ndryshme online apo dhe rrjete sociale, ku do të promovohet bashkëpunimi ndërmjet DPPI dhe AMCHAM, për aktivitete

të përbashkëta, do të ndahen dhe konfirmohen nga palët paraprakisht dhe më pas do mund të jenë të vlefshme për publikun.

NENI 4

KONFIDENCIALITETI

1. Përveç rasteve kur parashikohet me ligj ose nga një organ rregullator ose siç mund të kërkohe në mënyrë strikte për të përmbushur detyrimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje, secila Palë do të ruajë sekretin dhe konfidencialitetin dhe nuk do të përdorë, përhapë/zbulojë ose t'i bëjë të njohur ndonjë palë të tretë ndonjë informacion, që ka lidhje me objektin e marrëveshjes.
2. Kjo klauzolë nuk zbatohet për informacionin që është bërë publik në mënyra të tjera, përveç shkeljes së kësaj klauzole ose ndonjë detyrë tjetër konfidencialiteti ose është marrë nga një palë e tretë pa shkelur këtë klauzolë ose është kërkuar të bëhet e ditur nga ligji.
3. Palët nuk do të lejojnë përdorimin apo dhënien e çdo informacioni ose dokumenti konfidencial për qëllime të tjera, nga ato të përmendura në këtë marrëveshje bashkëpunimi.

NENI 5

INTERPRETIMI I MARRËVESHJES

1. Kjo Marrëveshje do të interpretohet duke marrë parasysh kushtet dhe afatet e saj në tërësi. Në çdo rast, çdo paragraf ose term që sjell paqartësi, do të interpretohet në kontekstin e të gjithë Marrëveshjes dhe në përputhje me qëllimin për të cilin palët lidhin këtë marrëveshje.
2. Për të gjitha çështjet që nuk përcaktohen shprehimisht në këtë Marrëveshje, zbatohen aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, të fushës përkatëse.
3. Nëse ndonjë parashikim në këtë Marrëveshje është i pavlefshëm, ose i pazbatueshëm, ky parashikim do të ndahet dhe të gjitha parashikimet e kësaj Marrëveshjeje, do të mbeten plotësisht në fuqi.

NENI 6

NDRYSHIMET E MARRËVESHJES

Marrëveshja e Bashkëpunimit mund të ndryshohet dhe revokohet në çdo kohë nga palët. Çdo ndryshim apo amendim i kësaj Marrëveshjeje, është i vlefshëm vetëm nëse bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga të dyja palët.

NENI 7

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE



Mosmarrëveshjet apo paqartësitë që mund të lindin në kuadër të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, zgjidhen me mirëkuptim nga palët, në bazë të ligjeve përkatëse në fuqi.

NENI 8

GJUHA

Kjo Marrëveshje hartohet në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe me vlerë të njëjtë dhe secila palë merr 2 (dy) kopje respektive të marrëveshjes.

NENI 9

NJOFTIMET DHE KORRESPONDENCA

Për të lehtësuar bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit sipas kësaj Marrëveshjeje, palët përcaktojnë personat e kontaktit dhe të gjitha komunikimet e palëve do të realizohen ndërmjet tyre, me përjashtim të rasteve kur është rënë dakord ndryshe.

NENI 10

HYRJA NË FUQI DHE KOHËZGJATJA

1. Marrëveshja hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit për një afat të pacaktuar.
2. Palët mund të zgjidhin në mënyrë të njëanëshme këtë Marrëveshje nga efektet në çdo kohë, duke njoftuar paraprakisht me shkrim palën tjetër.

PALËT

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME
E PRONËSISË INDUSTRIALE (DPPI)**

Përfaqësuar nga:

Znj. Maria SOLIS KAPEDANI

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM
I KOMANDAR**



**DHOMA AMERIKANE E TREGTISË
(AMCHAM)**

Përfaqësuar nga:

Z. Neritan MULLAJ

DREJTOR EKZEKUTIV

